

VENDIM
Nr.40, datë 27.1.1997

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.313, DATË
30.4.1996 “PËR ZYRAT E PAJTIMIT DHE ARBITRIMIT”**

Me propozimin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.313, datë 30.4.1996, pika 11 ndryshohet me këtë përmbajtje: “Procedura e pajtimit dhe e arbitrit, për palët që kërkojnë pajtim dhe arbitrim, është falas. Shpenzimet për procedurat e pajtimit dhe të arbitrit përballohen nga Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale.

Përfaqësuesve të punëmarrësve (anëtarë të zyrave të pajtimit dhe arbitrit) punëdhënësi duhet t’u japë leje pa të drejtë page, për ditët që ata marrin pjesë në seancat e pajtimit dhe të arbitrit. Përfaqësuesit e punëmarrësve, për çdo ditë që marrin pjesë në procedurën e pajtimit dhe të arbitrit, marrin pagë të barabartë me pagën ditore të vendit të tyre të punës. Kjo pagë u jepet nga sindikata që ata përfaqësojnë”.

Pas pikës 11 shtohet 11/1, me këtë përmbajtje:

“Për çdo arbitrim, kryetarit të zyrës së arbitrit i jepet një shpërblim prej 20 mijë lekësh, ndërsa sekretarit të arbitrit 25 për qind të shpërblimit të kryetarit të arbitrit. Pagesa bëhet në fund të çdo arbitrimi. Kur këta janë punonjës të institucioneve buxhetore, për shpërblimet që do të marrin për veprimtaritë e mësipërme nuk zbatohet kufizimi në masën e shpërblimeve i caktuar në paragrafin e parë të pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.720, datë 29.11.1995 “Për shpërblimin e punonjësve buxhetorë që aktivizohen në veprimtari të tjera dytësore”. Kur gjykata e deklaron vendimin qëllimisht të njëanshëm apo haptazi arbitrar, arbitri detyrohet të kthejë shpërblimin e marrë”.

3. Shpenzimet për procedurat e pajtimit dhe arbitrit për vitin 1996, të përballohen brenda fondeve buxhetore të Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale për vitin 1997.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi